



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**CN.nr.307/2024**

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Lumni Sallauka, kryetar, Rrustem Thaqi dhe Franciska Zhitia Ymeri, anëtarë, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Agjencia Pyjore e Kosovës – Drejtorati Koordinues Rajonal, me seli në Prizren, kundër të paditurës N.T.Sh. "I.," me numër të biznesit .., me seli në fshatin V., Komuna e P., me objekt kontesti lirim in e pronës dhe kompensimi i dëmit, vlera e objektit të kontestit e pacaktuar, përkitazi me konfliktin e kompetencës, në seancën e kolegjit të mbajtur më **21.11.2024**, merr këtë:

### **A K T V E N D I M**

Për të gjykuar në këtë çështje juridike kontestimore, kompetente në pikëpamje lëndore është Gjykata Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, të cilës shkresat e lëndës i dërgohen në kompetencë të mëtejme.

### **A r s y e t i m**

Paditësi Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Agjencia Pyjore e Kosovës - Drejtorati Koordinues Rajonal me seli në Prizren, më datë 21.06.2021 në Gjykatën Themelore në Prizren 2012, ka paraqitur padi kundër të paditurës N.T.Sh. "I.," me seli në V., Komuna e P., për lirim in e pronës, kthimin e tokës në gjendjen e mëparshme dhe kompensimin e dëmit.

Gjykata Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin C.nr.1193/2021 të datës 01.11.2022, në pikën I të dispozitivit është shpallur jokompetente në pikëpamje lëndore për procedimin e kësaj çështje juridike dhe në pikën II të dispozitivit ka vendosur që pasi që të bëhet i formës së prerë ky aktvendim, lënda së bashku me të gjitha shkresat, i dërgohet në kompetencë Gjykatës Komerciale në Prishtinë.

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin KE.nr.2722/22 të datës 21.10.2024, ka vendosur: I. Hapet konflikti i kompetencës në mes të Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, dhe

Gjykatës Komerciale të Kosovës - Departamenti për Çështje Ekonomike për të vendosur në çështjen juridike të paditësit Ministria e Bujqësisë - Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Agjencia Pyjore e Kosovës, Drejtoria Koordinues Rajonal me seli në Prizren, kundër të paditurës N.T.SH. "I," me seli në V., Komuna e P., me objekt kontesti lirimi i pronës dhe kompensimi i dëmit. Në pikën II të dispozitivit është vendosur që, për të vendosur lidhur me konfliktin e kompetencës lënda i dërgohet Gjykatës Supreme të Kosovës.

Gjykata Supreme e Kosovës ka vlerësuar se në këtë rast kemi të bëjmë me konfliktin e kompetencës midis gjykatave të ndryshme të cilin e zgjidh Gjykata Supreme e Kosovës bazuar në nenin 25.2 të LPK-së dhe nenin 13 pika 7 të Ligjit Nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se në këtë çështje konkrete juridike me kompetencë lëndore për të gjykuar është Gjykata Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, për këto arsye:

Me nenin 12 paragrafi 1 të Ligjit për Gjykatat nr.06/L-054, i shpallur në Gazetën Zyrtare nr. 22, datë 18 dhjetor 2018, parashihet që *gjykatat themelore janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet, përpos nëse me Ligj parashihet ndryshe*. Me nenin 13.1.1 të Ligjit për Gjykatën Komerciale nr. 08/L-015, të shpallur në Gazetën Zyrtare të Kosovës nr. 7, datë 10 shkurt 2022, parashihet që: *“Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në dhomat e shkallës së parë dhe shkallës së dytë, kontestet ndërmjet shoqërive tregtare, vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë, publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështjet tjera në mes tyre”,* ndërsa në nën pikën 7 të nenit 13.1 të këtij Ligji, parashihet e njëjta kompetencë e Gjykatës Komerciale *“kontestet në mes të shoqërive tregtare lidhur me të drejtat sendore, siç është paraparë me Ligjin për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare”*.

Nga shkresat e lëndës rezulton se çështja objekt shqyrtimi në këtë rast është kërkesa e paditësit Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Agjencia Pyjore e Kosovës - Drejtorati Koordinues Rajonal me seli në Prizren, kundër të paditurës N.T.Sh. "I.", lidhur me çështjen lirim i pronës dhe kompensim i dëmit. Për të vendosur lidhur me atë se cila gjykatë është kompetente për të vendosur lidhur me këtë çështje objekt shqyrtimi, kjo gjykatë si fakt vendimtar merr statusin e paditëses, që në këtë rast është Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Agjencia Pyjore e Kosovës - Drejtorati Koordinues Rajonal, nuk e ka statusin e shoqërisë tregtare por statusin e personit juridik publik, andaj në këtë rast nuk mund të aplikohet neni 13, paragrafi 1, pika 1.1 dhe 1.7 të Ligjit për Gjykatën Komerciale. Meqë Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Agjencia Pyjore e Kosovës – Drejtorati Koordinues Rajonal, nuk është shoqëri tregtare e as person juridik privat, marrë parasysh edhe objektin e kontestit që është lirim i lokalit dhe kompensim i dëmit dhe faktin se në kuptim të nenit 41 të LPK-së, kompetenca ekskluzive për zgjidhjen e këtyre kontesteve është e gjykatës në territorin e të cilës ndodhet paluajtshmëria kontestuese, e të cilat janë në territorin e Komunës së Prizrenit, rezulton se për të gjykuar në këtë

çështje juridike, e kompetencës lëndore në rastin konkret duhet të jetë Gjykata Themelore në Prizren.

Gjykata Supreme e Kosovës pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, nisur nga fakti se objekt i kontestit realisht është në mes një shoqërie tregtare dhe një personi juridik publik, lidhur me çështjen e lirimit të lokalit dhe kompensimit të dëmit, bazuar në dispozitën e lartcekur, kjo çështje duhet të trajtohet dhe vendoset nga Gjykata Themelore Prizren.

Nga sa u tha më lart, e në kuptim të dispozitës së nenit 25.2 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË**  
**CN.nr.307/2024, datë 21.11.2024**

**Kryetari i kolegjit - gjyqtari**  
Lumni Sallauka